



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101396/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandohet propozimi për ndryshimin të nenit 3 të ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuareve me burgimi dhe të paraburgosuri".

Drejtuar: z. Ulsi MANJA
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Për dijeni: Znj. Klotilda BUSHKA
Kryetare, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
Dhe të Drejtat e Njeriut.

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit ne permbushje te misionit të tij kushtetues e ligjor per mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave te ligjshme te individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e te parregullta te organeve te administrates publike, ka filluar trajtimin me iniciativë të problematikave dhe shqetesimeve qe kane lindur gjatë dhe pas protestes se ndërmarrë nga nje numër individësh në afersi të Thines/Mirdite, ne mbeshtetje te një gështjeje për mbrojtjen e ambientit per shkak të nderhyrjeve qe janë ndërmarrë ne kuadër te ndertimit të një hidrocentrali.

Në datë 22.10.2021, në media është bërë publik lajmi, sipas të cilit dhjetra të dënuar dhe të paraburgosur në IIEVP Burrel refuzojnë ushqimin, në shenjë proteste për numrin e ulët të takimeve mujore me familjarët, pasi për shkak të pandemisë u lejohet vetëm një takim në muaj me ta. Gjithashtu, ata kanë kërkuar të zgjerohet rrethi i familjarëve, me të cilën mund të marrin takim.¹

¹ <https://politiko.al/e-tjera/dhjetera-te-denuar-ne-burgun-e-burrelit-refuzojne-ushqimin-kerkojne-me-s-i446164>

Me vënien në dijeni të këtij lajmi, nga ana e institucionit të Avokatit të Populli u ngrit grupi i punës i përbërë nga ndihmëskomisionerët, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe intervistimin e të burgosurve, në lidhje me pretendimet që ata kanë ngritur.

Në vijim të inspektimit tematik, u morën takime me të burgosurit e sigurisë së zakonshme dhe të burgosurit e sigurisë së lartë. Nga shqetësimet e ngritura ndër të tjera ata theksojnë:

- ✚ Kërkojmë takim me familjarët me këdo person, duke përfshirë gjakun më të afërt, si nipat, mbesat, xhaxhallarët etj., ashtu siç parashikohej në ligjin e mëparshëm, sipas të cilit mund të ta takojmë çdo person pa kufizim. Po ashtu kërkojmë rishikimin e nenit 3 të Ligjit 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” ose gjetjen e një zgjidhje tjetër për këtë problem. (Si argument për këtë kërkesë ato sollën faktin se disa të burgosur janë në hasmëri dhe për t’ju ruajtur gjakmarrjes nuk mund të sjellin në burg rrethin e ngushtë familjar; disa të burgosur rrethin e familjarëve të përcaktuar në ligj e kanë të emigruar jashtë vendit; prindërit mund të jenë në pamundësi fizike për t’i takuar për shkak të moshës dhe sëmundjeve; kanë dëshirë të takojnë xhaxhain, tezen, hallën etj. që mund të vij nga emigracioni për t’i parë; kanë dëshirë të takojnë dhëndrin e vajzës të sapomartuar; kanë dëshirë për të takuar nipin dhe mbesën për të çliruar ngarkesën psikologjike që shkakton burgun; nga njëra anë ligji i jep rëndësi të veçantë rivendosjes së lidhjeve të të burgosurve me familjen dhe nga ana tjetër e kufizon atë).
- ✚ Po ashtu, ata iu referuarn ligjit të mëparshëm nr.8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar, në nenin 41 të tij parashikonte se: “*Të paraburgosurit dhe të dënuarit lejohen që të kenë takime dhe korrespondenca me familjarët dhe persona të tjerë*”, praktikisht me çdo person. Ndërsa ligji që është në fuqi aktualisht, i cituar më lart, e kufizon rrethin e personave me të cilët i burgosuri mund të marri takim dhe synimi i këtij ndryshimi mund të ketë qenë parandalimi i kontakteve për qëllime kriminale.

Nga ana jonë u administrua udhëzimi mbi procedurën e vizitave të burgosurve me familjarët në kushtet e pandemisë dhe masat parandaluese, ku shkruhet se vizitat e të burgosurve me familjarët e tyre do të fillojë me datën 14.06.2021 duke realizuar një takim në muaj për çdo të burgosur madhor (burra dhe gra) deri në një urdhër të dytë². fotokopje e fletës së fundit të Regjistrisë të kërkesë/ankesave dhe procesverbalin të datës 23.10.2021, ku nënshkruan një grup të burgosurish me gjeneralite dhe nënshkrim përkatëse në lidhje me takime me familjarët dhe të afërmit e tyre.

Gjithashtu, në institucionin e Avokatit të Popullit në datën 01.11.2021 është regjistruar ankesa e dërguar nga një grup prej 47 të burgosurish, të identifikuar me gjeneralitetet dhe nënshkrimet përkatëse, të cilët ndodhen duke kryer dënimin penal me burgim në IEVP Burrel. Në këtë ankesë ata kanë ngritur të njëjtën shqetësim që e kanë ngritur përpara eksperteve të institucionit të Avokatit të Popullit, për zgjerimin rrethi i familjarëve, me të cilën mund të marrin takim, duke ju referuar ligjit të mëparshme nr.8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar, ku parashikonte që të burgosurit lejohen që të kenë takime me familjare dhe persona të tjerë. Po ashtu ata kanë ngritur shqetësimin e tyre lidhur me kufizimin e të drejtës ligjore

² Udhëzim nr. 6285/1 datë 14.06.2021 “Mbi procedurën e vizitave të Burgosurve me familjarët në kushtet e pandemisë dhe masave parandaluese”.

për të komunikuar në telefon me familjarët dhe të afërmit jashtë burgut. Sipas tyre, para disa kohësh Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka nxjerrë një urdhër i cili detyron të burgosurit që të deklarojnë një listë me vetëm 10 numra telefoni me të cilët ata do të komunikojnë me të afërmit e tyre. Nëse do të duhet të shtojnë një numër të ri telefoni, duhet të heqin një nga numrat e telefonit që ata kanë dhënë më parë në listë, por kjo procedurë zgjat një muaj. Ndërkohë ata shprehen se nuk janë të shqetësuar nga deklarimi i kodit personal për ta ditur institucioni se me cilin person flasin, por të kenë mundësi për të komunikuar në telefon me më shumë familjarë, të afërm, miq e shokë të tyre duke mos kufizuar numrin e telefonave, pra të personave me të cilat do të komunikojnë. Në vijim ata shprehen se duke qenë se çdo institucion është i detyruar të zbatojë drejtëpërdrejtë Kushtetutën, si ligj themeltar i shtetit kërkojnë që të ktheni takimet dhe telefonatat siç kanë qenë përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve anti-kushtetuese.

Gjatë vitit 2021, të së njëjtës periudhe, kanë ngritur të njëjtë shqetësim dhe të burgosurit e IEVP-së Peqin, Reç etj, ku një numër i konsiderueshëm të dënuarish në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë ndryshimin ose rishikimin të nenit 3 të “ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku përcakton se “Anëtarët e familjes” së të paraburgosurit dhe të dënuarit janë bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, fëmijët, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, bashkëjetesa e të cilëve ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar. Ata kërkojnë se takim me familjarët të jetë në një rreth me të gjërë, duke përfshirë gjakun më të afërt, si nipat, mbesat, xhaxhallarët, miq etj.,

Pas një hetimi administrativ të kësaj ankese të një grup të burgosurish në IEVP Burrel, dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar lidhur me këtë rast, si dhe vlerësimi i ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të Paraburgosurve”, në raport standardet e disa ligjeve ndërkombetare, konstatojmë se:

- ✚ përmirësimi i kushteve për trajtimin e personave të dënuar me burgim për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet e Bashkimit Europian, aktet ndërkombëtare në fuqi si dhe standartet e pranuar ndërkombëtarisht, ku të burgosurveve u lejohet të kenë intervista dhe korrespondencë me të afërm dhe persona të tjerë, edhe për kryerjen e akteve ligjore komunikimit, me çdo person në botën e jashtme.
- ✚ Ligji mbi të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve vendos rregulla të reja mbi respektimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve³. Duke mos përcaktuar si qëllim parësor komunikimin e tyre me botën e jashtme. Por përforcimin e sigurisë nëpër burgje, përmes kufizimeve në takim me familjarët në një rreth të ngushtë tyre, si dhe i detyron të burgosurit që të deklarojnë një listë me vetëm 10 numra telefoni me të cilët ata do të komunikojnë me të afërmit e tyre. Nëse do të duhet të shtojnë

³ Neni 3/1 i ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, përcakton se: “Anëtarët e familjes”, së të burgosurit dhe të dënuarit janë bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, fëmijët, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat, si dhe bashkëjetuesi/bashkëjetuesja etë cilëve ka në karakter të qëndrueshëm dhe të provuar”. Neni 49/1 parashikon se: “I burgosuri ka të drejtën e vizitës të paktën katër herë në muaj me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë”.

një numër të ri telefoni, duhet të heqin një nga numrat e telefonit që ata kanë dhënë më parë në listë, por kjo procedurë zgjat një muaj. Me qëllim parandalimin e lidhjeve të mëtejshme me botën e krimit për personat që vuajën dënimin nëpër burgje, duke ndihmuar kështu dhe në shikëputjen përfundimtare të tyre nga krimi. Nga ana tjetër, nuk parashikon një trajtim që synon rehabilitimin social për riintegrimin e të dënuarve në jetën familjare, sociale dhe ekonomike përmes programeve rehabilitimit social, që synojnë modifikimin e sjelljeve kriminale dhe vënien e institucioneve ligjzbatues në lëvizje për komunikimet e papërshtatshme që mund të ketë një i burgosur me botën e jashtme.

Për sa më lart dhe duke ju referuar standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të shteteve të huaja si Italia⁴, Serbia⁵, Kosova⁶, Maqedonia e Veriut⁷ etj. vërejmë se parashikimet e tyre ligjore për takimin e të burgosurve me botën e jashtme përfshijnë një rreth më të gjërë si familjen e ngushtë, të afërmit dhe miqtë.

Pra rezulton se këto takime si dhe korrespondenca përfshijnë edhe të tretë, duke e zgjeruar rrethin me persona si nipër e mbesa, miq të vjetër të cilët edhe mund të vijnë fizikisht të takojnë të burgosurit. Ky parashikim ndihmon në gjendjen e tyre psikologjike dhe emocionale, duke mos harruar se në Shqipëri shumica e të afërmeve ose nuk ndodhen në territorin e Shqipërisë ose e kanë të vështirë kontaktin me të burgosurit për shkak të distancës, duke sjellë shpesh herë një pamundësi të përgjithshme në realizimin e këtyre takimeve.

Ndërkohë që, të burgosurit u shprehën se kanë bërë disa herë kërkesa edhe pranë institucioneve përgjegjëse si Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në lidhje me realizimin e kërkesave të tyre, përkatësisht për ndryshimin e nenit 3, të ligjit nr. 81/2020, i cili parashikon një rreth të ngushtë familjarësh të cilët lejohen në takime me të burgosurit duke sjellë për pasojë një përkeqësim të gjëndjes së tyre psikologjike.

Gjithashtu, jeta familjare është një e drejtë themelore e njeriut. Në kuadrin e paraburgimit, kjo do të thotë që vizitat ndërmjet të paraburgosurve dhe familjeve të tyre nuk duhet të konsiderohen asnjëherë si një privilegj që mund të hiqet si masë disiplinore.

Sipas percaktimeve të APT (Association for the Prevention of the Torture)⁸ parashikon se çfarë kuptojmë me familje? Termi 'familje' duhet të interpretohet gjerësisht. Termi "partner" duhet të përfshijë burrin ose gruan, si dhe partnerin de facto dhe të të njëjtit seks. Familja duhet të përfshijë edhe persona të tjerë të rëndësishëm në jetën e një të paraburgosuri, si gjyshërit, ose një mik të vjetër dhe të ngushtë. Grupe të veçanta të pakicës ose indigjene mund të kenë një koncept kulturor specifik të familjes që mund të ketë një vlerë më të madhe për një individ në krahasim me kulturën kryesore ose mbizotëruese. Për shembull, në disa komunitete indigjene, familja është thelbësore për jetën e komunitetit dhe burgimi mund të ketë një ndikim akut si te të paraburgosurit ashtu edhe te komuniteti. Autoritetet e paraburgimit mund të jenë të ndjeshme ndaj këtyre çështjeve, për shembull

⁴ Konsulto: <https://www.altalex.com/documents/codici-altalex/2018/11/26/legge-sull-ordinamento-penitenziario>.

⁵ Konsulto: <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Mercenaries/EG/Laë/Serbia/CriminalCode.pdf&https://www.yihf.rs/ep-content/uploads/2016/06/Prava-lica-li%C5%A1enih-slobode-ENG.pdf>.

⁶ Ligji nr. 04/L-149 "Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale Kuvend i Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 62.

⁷ Konsulto: <https://www.refworld.org/pdfid/46963af60.pdf>.

⁸ <https://www.apr.ch/en/knowledge-hub/detention-focus-database/contacts-outside-world/family-visits>

duke i lejuar të paraburgosurit të largohen për të marrë pjesë në funeralet e anëtarëve të familjes së gjerë.

Në rastet kur një i paraburgosur nuk ka familje ose nuk dëshiron të mbajë kontakte, mund të jetë e përshtatshme që autoritetet të lehtësojnë kontaktin me vizitorët vullnetarë në mënyrë që të ruajnë lidhjen e të paraburgosurit me botën e jashtme.

Në Republikën e Shqipërisë, kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.⁹

Në vijim bazuar në ligjin nr. nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar dhe konkretisht në nenin 24, germa “b”, “E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative” e ku parashikohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre, shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: b): t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

1. Marrja e masave të nevojshme që të rishikohet neni 3 “Përkufizime”, i ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”, përkatësisht në pikën 1 të tij ku përkufizohen “Anëtarët e familjes”, në funksion të zgjerimit të këtij rrethi.
2. Marrjen e masave të nevojshme për garantimin e të drejtës të të burgosurve për të kryer biseda telefonike me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, sipas akteve ligjore në fuqi.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkohet të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

⁹ Pika 1 dhe 2, të nenit 17, të Kushtetutës e Republikës së Shqipërisë.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA